



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1018/3 Prot.

Tiranë, më 03/09/2020

V E N D I M

Nr. 99 , Datë 03 /09 / 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.75 regj, datë 17.07.2020, të paraqitur nga ankuesi J.B kundër Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *aftësisë së kufizuar*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar ankuesi ka parashtruar se:

Unë J.B me profesion kopshtar, jam punëtor i Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a (UKSH sh.a) që nga viti 2019 me pozicion “Punëtor gjelbërimi”, punë kjo që i përshtatet aftësisë time për punë, pasi unë jam një person me aftësi të kufizuar dhe vuaj nga sëmundja e epilepsisë.

Unë pretendoj diskriminim nga ana e UKSH sh.a, sepse me datë 18.06.2020 është marrë vendim nga Drejtori i UKSH sh.a të më transferojë nga pozicioni “Punëtor gjelbërimi”, në pozicionin “Punëtor Sektori KUB”, një punë shumë e vështirë për aftësinë time. Duke qenë se unë jam një person me aftësi të kufizuar duhet që pozicioni i punës të jetë i përshtatshëm me aftësinë time për punë dhe shkalla e vështirësisë të jetë në proporcion me aftësinë time të kufizuar. Sipas aftësisë time për punë ky pozicion nuk më përshtatet dhe është diskriminues.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Sa më sipër kërkoj nga Komisioneri që të urdhërojë marrjen e masave për rikthimin tim në pozicionin e mëparshëm si “Punëtor Gjelbërimi”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”², që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me *aftësinë e kufizuar* të pretenduar nga ankuesi (neni 1³). Neni 3, i Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, *bazuar në aftësinë e kufizuar*, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, *aftësinë e kufizuar*, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) *trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

- Me shkresën nr.1018/1 prot., datë 21.07.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.
- Me shkresën nr.982/1 prot., datë 29.07.2020⁵ Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a ka informuar se:

“Referuar dosjes së tij personale pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të UKSH, J.B ka filluar punë në pozicionin “Punëtor gjelbërimi” pranë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër me datë 05.03.2019 sipas urdhrin të brendshëm nr. 59, datë 04.03.2019 dhe kontratës individuale të punës datë 05.03.2020. Punësimi i z. B është bërë sipas përcaktimeve të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Brendshme të UKSH nr. 23, datë 13.09.2017, duke bërë deklarin e vendit të lirë të punës së shpallur pranë Zyrës së Punësimit Shkodër me shkresën nr. 221 prot., datë 27.02.2019. Përpara emërimit në punë z. B ka depozituar pranë UKSH dokumentacionin e kërkuar. Ndër të tjera ka depozituar edhe Raport Mjeko-Ligjor datë 01.02.2019 lëshuar nga Poliklinika Shkodër me nr.regjistri 2224, ku konstatohet se z. B është i aftë për punë. Gjithashtu në kuadër të ripërtëritjes së dokumentave të nevojshme në dosjen personale, z.B ka depozituar pranë UKSH Raportin Mjeko-Ligjor me nr. 1423, datë 03.06.2020, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr.2, ku konkludohet “I aftë për punë”.

Me urdhrin e brendshëm nr. 843 prot., datë 18.06.2020 z. J.B është transferuar nga pozicioni “Punëtor gjelbërimi” në Pozicionin “Punëtor në Sektorin KUB (kanalet e ujrave të bardha). Ky transferim është bërë në kuadër të përmirësimit të efikasitetit në realizimin e detyrave, pasi herë pas here janë vërejtur mangësi nga ana e punëmarrësit në realizimin e punës së caktuar. Për këtë transferim punëmarrësi nuk ka paraqitur ankesë pranë punëdhënësit.

Referuar përcaktimeve të ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe dokumentacionit që ndodhet në dosjen e tij personale pranë Burimeve Njerëzore të UKSH (sikurse cituam më sipër), punëmarrësi J.B nuk është subjekt i këtij ligji, pasi z. B nuk gëzon statusin e personit me aftësi të kufizuar referuar dokumentave të lëshuar nga institucionet shëndetësore dhe të dorëzuar pranë UKSH nga vetë punëmarrësi në momentin e emërimit në punë dhe ripërtëritjes së dokumentave sipas Raportit Mjekësor të datës 03.06.2020.”

Në datën 31.08.2020 ankuesi ka paraqitur një deklaratë nëpërmjet të cilës deklaroi se tërhiqet nga çështja dhe nuk dëshiron që të vazhdojë më tej me ankesën.

Bazuar në nenin 90 “Përfundimi i procedurës administrative”, paragrafi 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”

⁵ Protokolluar pranë KMD me nr. 1018/2 prot., datë 03.08.2020.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Bazuar në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, paragrafi 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi J.B, i cili me anë të deklaratës së datës 31.08.2020 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 3, nenin 33 pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, nenin 90, pika 3 dhe 94, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 75 regjistri, datë 17.07.2020, të paraqitur nga ankuesi J.B kundër Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.
1. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Punësim

Shkaku: Aftësia e kufizuar

Lloji i vendimit: Përfundim i shqyrtimit për shkak të tërheqjes së ankesës